

Në bazë të nenit 3 të Rregullores për kriteret, kushtet dhe procedurën për “Zgjedhje të sportistëve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit”, organizatori “Lidhja e federatave sportive të Maqedonisë”, publikon:

KONKURS

Për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve në zgjedhjen e sportistëve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit për vitin 2017

1. “Lidhja e federatave sportive të Maqedonisë” ngritë procedurë për Zgjedhje të sportistëve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit për vitin 2017.
2. Zgjedhja e sportistëve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit, ndahet për rezultate të arritura në sport individual dhe ekipor gjatë vitit aktual, të sportistëve dhe trajnerëve të cilët marrin pjesë për ekipe sportive, selia e të cilave është në Shkup.
3. Të drejtë për propozimin e kandidatëve për Zgjedhje të më të suksesshmëve, kanë ekipet sportive, dhe anëtarët e tyre, selia e të cilave është në Shkup.
4. Propozimet për Zgjedhje të sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit, janë për kategoritë në vijim:
 - 10 sportistët më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve (meshkuj dhe femra);
 - 5 sportistët më të suksesshëm në kategorinë e të rinjve (meshkuj dhe femra);
 - Trajneri më i suksesshëm;
 - Ekipi më i suksesshëm sportiv nga Shkupi;
 - Sportisti/ja më i/e suksesshëm/e – i huaj i cili luan në ekip nga Shkupi dhe
 - Sportisti/ja më i/e suksesshëm/e në kategorinë e personave me nevoja të posaçme.
5. Kriter për realizimet sportive janë rezultatet e arritura në kampionatet olimpike, botërore, evropiane dhe gara të tjera ndërkombëtare.
Në garat përkatëse ku është realizuar rezultati sportiv, kushtet për nominim të sportistëve në sportet individuale në zgjedhjen e sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit janë:
 - Në Kampionat botëror ku marrin pjesë minimum 30 vende dhe në të njëjtën marrin pjesë së paku 8 garues në konkurrencë individuale dhe kanë realizuar së paku dy fitore;
 - Në Kampionat evropian ku marrin pjesë minimum 15 vende dhe në të njëjtën marrin pjesë së paku 8 garues në konkurrencë individuale dhe kanë realizuar së paku dy fitore.
6. Klubet dhe anëtarët nga ekipet sportive radhiten përmes pjesëmarrjeve në garat e mëdha, të cilët marrin pjesë më herët në gara në kualifikime dhe grupe në ligë evropiane të kampionëve, euro ligat, kupat evropiane dhe gara të tjera rajonale.
7. Nominimet për kategoritë e lartpërmendura sportive i dorëzojnë klubet sportive dhe anëtarët e tyre të cilat gravitojnë në rajonin e Qytetit të Shkupit, me dokumentacion të rregulluar: kopje të regjistrimit të subjektit me seli në Shkup, kopje të librezës së regjistrimit të sportistit të nominuar për pjesëmarrje në gara gjatë vitit aktual, dokument zyrtar për rezultatet e arritura sportive të publikuara në buletine, ueb faqe, kod sisteme etj.
8. Shpallja publike zgjatë shtatë (7) ditë duke llogaritur nga dita e publikimit.
(prej më 12.12 deri më 18.12.2017 deri në ora 15.00)
Propozimet dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 15:00 në hapësirat e Lidhjes së federatave sportive të Maqedonisë në hapësirën e galerive me sallën Parku i Qytetit në rrugën nr. 1732 Shkup, me shenjë “Departamenti për sport” për “Zgjedhje të sportistes dhe sportistit, trajnerit, ekipit sportiv më të suksesshëm të Qytetit të Shkupit për vitin 2017”.

Lidhja e federatave sportive të Maqedonisë

- Qyteti i Shkupit, “Departamenti për sport”

**- Komisioni për zgjedhje të sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve sportive më të suksesshëm të Qytetit të Shkupit,
dhe ndarja e çmimeve dhe mirënjohjeve”**